

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, Ndreca: Zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për demokracinë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/gjykata-e-larte-la-ne-burg-veliajn-ndreca-zhvillim-jashtezakon-isht-shqetesues-per-demokracine/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:18:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:13:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7d0a4aeb5b28a8e4110111a6a2de32b300e91919a35f24a4b83675b2b3b63b53
TEKSTI	f0ba5bb70201b16dfbdf444caab3285de7e522351a583f7905fb1a3cfe2de788
PAMJA	793fe8536c4e623e7d37741f8d064bafef8508315c2de966747348cd85b2bdd0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aa07a6966b558d19a792cdd994d0e0c4272a6217145cb127bacabb26a78476d9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aa07a6966b558d19a792cdd994d0e0c4272a6217145cb127bacabb26a78476d9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Avokati Plarent Ndreca, ka reaguar pas vendimit të sotëm të Gjykatës së Lartë, e cila la në burg kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajn.

Ndreca e ka cilësuar vendimin një zhvillim “jashtëzakonisht shqetësues” për shtetin e së drejtës dhe demokracinë, duke ngritur pikëpyetje mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Avokati shkruan në rrjetet sociale se Veliaj po mbahet prej 19 muajsh në qeli, ndonëse hetimet ndaj tij kanë përfunduar dhe çështja është në gjyq.

“Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, avtetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur.

5 Kokainë me vlerë 2 mil euro brenda kontejnerit me mish nga Brazili

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Z. Erion Veliaj presumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim.

E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojnë dhe t'i kufizojnë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes "lawfare"-it.

Ne do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare.

Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin", shkruan Plarent Ndreca.

#avokat

#ndreca

#Veliaj

#VizionPlus



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**GJKKO rrëzon
kërkesën për liri të...**

Xhuljana
Zhuleku

36 minuta
më parë



POLITIKË

**Kryeministri Rama në
Napoli, vizitë në...**

Xhuljana
Zhuleku

1 orë më
parë



POLITIKË

**Gjykata e Lartë
vendos sot për...**

Xhuljana
Zhuleku

4 orë më
parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentën



Vizion Plus është një nga televizionet

Lajme

Politikë

Bota

Programe

Programe

Seriale

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme,
programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt
dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Vendi
Kronikë
Lifestyle

Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.